



Datë: 01.08.2025
Numër Protokolli: 5205/2025

A.nr.1198/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1198/2025, të datës 23.06.2025, të parashtruar nga ankuesi S.H kundër organit të punësimit/Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.1198/2025, e datës 23.06.2025, e parashtruar nga ankuesi S.H.
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.112-17545/2025 i datës 12.06.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, S.H (*tani tutje referuar: ankuesi*), më datë 23.06.2025 përmes e-mailit ankesa.kpmshek@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli:4270/2025, kundër Vendimit Nr.112-17545/2025 të datës 12.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës lidhur me njohjen e përvojës së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, ndërsa Këshilli më datë 04.07.2025 ka pranuar nga kjo e fundit përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 4270/2025 të datës 23.06.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; E-mailin e datës 23.06.2025 dërguar nga ankuesi për ankesa.kpmshck@rks-gov.net; Vendimin e datës 12.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës; Shkresa-kopje të gazetës Bota Sot; Mirënjohje e datës 8 qershor 2003; Kopje e kartelës identifikuese e datës 01.01.2006 nga gazeta Zëri; Kopja e letërnjoftimit të ankuesit; Fletëpagesë e lëshuar nga Thesari për pagën e muajit maj 2025; Vërtetimin e datës 02.12.2020 lëshuar nga Bota Sot; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.06.2025; Përgjigje në ankesë e datës 01.07.2025; E-mailin e datës 29.04.2025 dërguar nga E.M për ankuesi dhe të tjerët; E-mailin e datës 05.06.2025 dërguar nga E.M për ankuesin; Vërtetimin e lëshuar nga gazeta Zëri i datës 16.02.2017; Pasqyra e Llogarisë së Trustit për ankuesin; Akt Emërimit e ankuesit të datës 06.05.2025; Listën e pagave për muajt janar-qershor 2026; Emalin e datës 29.07.2025 dërguar nga Këshilli për Xh.D; Përgjigjen e datës 29.07.2025 dërguar nga Xh.D për Këshillin;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e papabuar, **sepse**:

Nga provat e administruara në këtë procedurë administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi sipas Akt Emërimit Nr.112-13447/2025, të datës 06.05.2024, është i punësuar në pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 2, në ZGJC-Gllarevë, në kuadër të Drejtorisë për Administratë, në Komunën e Klinës, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore përmes Vendimit Nr.112-17545/2025 të datës 12.06.2025 ankuesit ia ka njohur përvojën e marrëdhënies së punës, në kohëzgjatje prej gjashtëmbëdhjetë (16) vite, e shtatë (7) muaj.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundër aktit të kontestuar, pretendon se organi i punësimit ia ka mohuar përvojën e punës pasi që i njëjti pretendon se ka mbi 20 vite, e 7 muaj përvojë punë, me arsyetimin se një gjë të tillë e mbështesë edhe me dëshminë e konfirmuara nga Thesari i Kosës për konfirmimin e pagës/kontributeve për muajin maj 2025, sikurse lidhur me përvojën e punës në gazetën Bota Sot posedojë dëshminë që konfirmohet fakti i marrëdhënies së punës nga viti 199 e deri në vitin 2005, ashtu që largimi i 4 viteve të përvojës së punës nga organi i punësimit është i pa pranueshëm ngase për çështjen përkatëse posedojë provat e nevojshme, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e tij, ndërsa të anuloi vendimin e datës 12.06.2025 duke e detyruar organin e punësimit që ankuesit t'ia njoh përvojën e punës në periudhën kohore prej katër (4) vitesh, 2003-2007, ashtu sikurse i njëjti e ka pasur paraprakisht deri në muajin maj të vitit 2025.

Kolegji i Këshilli, para se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, analizoi aktin e kontestuar, gjegjësisht Vendimin Nr.112-17545/2025 të datës 12.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, sipas të cilit akt, ankuesit i është njohur e drejta në përvojën e punës në kohëzgjatje prej gjashtëmbëdhjetë (16) vite, e shtatë (7) muaj, ashtu që aktin e kontestuar Njësia përkatëse e ka nxjerr duke iu referuara dispozitave të Rregullores për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, ndërlidhur me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të shkresave të lëndës konstatoi se Njësia e Burimeve Njerëzore, parapara nxjerrjes së aktit të kontestuar, me datë 29.04.2025 përmes e-mailit zyrtar iu është drejtuar zyrtarvë të komunës, në mesin e tyre edhe ankuesit, me njoftimin se Njësia e Burimeve Njerëzore, nga Auditori i jashtëm është obliguar për secilin nëpunës të nxjerrë Vendim për njohjen e përvojës së punës me qëllim të arsyetimit të shpenzimeve në emër të përvojës së punës, po ashtu në këtë shkresë njësia përkatëse thekson se sipas dispozitave të Rregullores Nr.05/2023 Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, nenin 6, paragrafi 2, nënë paragrafi 2.2 ka përcaktuar se përvoja e punës

në institucionet private mund të bëhet vetëm me Trust apo vërtetimit të lëshuar nga ATK-ja, me kërkesën që ata që përvojën përkatëse të punës e kanë në sektorin privat me qëllim të njohjes së kësaj përvoja në afat prej pesë (5) ditësh duhet të ofrojnë pasqyrën e trustit pranë njësisë përkatëse të personelit, në të kundërtën periudha përkatëse nuk mund të përfshihet në përvojën e punës.

Po ashtu, Njësia e Burimeve Njerëzore, me datë 05.06.2025 i është drejtuar përsëri me shkresë ankuesit, duke e njoftuar ankuesin se duhet të ofrojnë pasqyrën e Trustit apo dëshminë e lëshuar nga ATK-ja, më së vonë deri me datë 09.06.2025 për përvojë e punës të deklaruara në gazetën Bota Sot nga data 01.11.199 e deri me datë 31.12.2005 dhe gazetën Zëri nga data 01.01.2006 e deri me datë 31.07.2012, ndërsa nga shkresat e lëndës të deklaruara në sektorin privat nga ankuesi, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi ka ofruar pranë organit të punësimit Vërtetimin e datës 02.12.2020 të lëshuar nga gazeta Bota Sot sipas të cilit deklarohet se ankuesi ka punuar në këtë institucion nga data 01.11.199 e deri me datë 31.12.2005, dhe po ashtu kishte ofruara pranë organit të punësimit pasqyrën e llogarisë së trustit përmes së cilit konfirmohet fakti se ndaj anketuesit, gazeta Zëri kishte paguar kontributet pensionale për periudhën kohore nga muaji qershor 2007 e deri në muajin shtator 2015 sikurse ankuesi pranë këshillit e kishte ofruar në cilësi të provës edhe kartelën identifikuese të gazetarit Nr.12 të lëshuar nga Gazeta Zëri të datës 01.01.2006, dhe po ashtu konstatoi se sipas dëshmisë së lëshuar nga Thesari i Kosovës për ekzekutimin e pagës së muajit maj 2025, konfirmohet fakti se ankuesi ka njëzetë (20) vite e shtatë (7) muaj përvojë pune.

Kolegji i Këshillit në shqyrtim të kësaj çështje në procedurë administrative, analizoi dhe mori për bazë dispozitat e aplikuara nga Rregullorja Nr.05/2023 Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, nenin 6 paragrafi 2, nën paragrafin 2.2 dhe paragrafin 3 dhe 4 të saj, ku përcaktohet se: **“2. Përvoja e punës dëshmohet përmes njërës prej dëshmive si vijon: 2.2. pas qershorit 1999: 2.2.1. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga njësia kompetente për menaxhimin e personelit në Institucionet e Republikës së Kosovës ose nga misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë; 2.2.2. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga ndërmarrjet publike ose nga ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë qenë ose janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim; 2.2.3. dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin; 2.2.4. dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent; 2.2.5. dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i një shteti të huaj në të cilin punëtori ka punuar; 2.2.6. çdo dëshmie tjetër të vërtetuar në procedurë gjyqësore përmes aktgjykimit të plotfuqishëm; 2.2.7. dëshmi tjetër plotësuese mund të konsiderohet edhe lista e pagave. 3. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore në çdo institucion, në pajtim me këtë rregullore, vendosë për njohjen e përvojës së punës së një nëpunësi i cili merr pagë nga buxheti i Kosovës. Vendimi i përvojës së punës bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin i punësuar dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi. 4. Të punësuarit aktual në sektorin publik të cilët e kanë të evidentuar përvojën e punës, nuk i nënshtrohen zbatimit të paragrafit 3 të këtij neni.”**

Fillimisht, në vështrim të kuadrit ligjor në fuqi dhe marr për bazë nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores Nr.05/2023 Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, ku përcaktohet se: **“Të punësuarit aktual në sektorin publik të cilët e kanë të evidentuar përvojën e punës, nuk i nënshtrohen zbatimit të paragrafit 3 të këtij neni.”** dhe me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit me datë 29.07.2025 i është drejtuar Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës me kërkesën për sqarime shtesë, si në vijim **citohj:** **“A mund të na e konfirmoni faktin nëse ankuesi e ka pasur paraprakisht (në të kaluarën) të evidentuar përvojën e punës nga organi i punësimit/Komuna e Klinës; Nëse po, ju lutem të na e bashkëngjitni aktin përkatës.”**, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 29.07.2025 ka kthyer përgjigjen si në vijim, **citohj:** **“Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet këtij emali ju sqaron se para vendimit të dt. 12.06.2025, me nr. 02-112-17545/2025, nuk ka nxjerr asnjëherë vendim mbi njohjen e përvojës së punës për ankuesin. Pra, asnjëherë nuk ka nxjerr**

*vendim mbi bazën e te cilit ja ka njohur përvojën e punës që figuron ne listën e pagave.”, sikurse me të njëjtën kërkesë për sqarime dhe prova shtesë, Kolegji i Këshillit përmes zyrtarit të autorizuar i është drejtuar edhe palës ankuese përmes e-mailit të datës 31.07.2025 me kërkesën si në vijim, **citohet**: “... me qëllim të shqyrtimit meritor, ju lutem a mundeni ta mbështesë me dëshmi shtesë, marrëdhënien së punës të deklaruar në gazetën Bota Sot sipas vërtetimit të datës 02.12.2020, për periudhën kohore 01.11.1999 e deri 31.12.2005; Sipas nenit 6 paragrafi 2, (pika 2.2.7) të Rregullores Nr.05/2023 Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, dëshmi plotësuese mund të konsiderohet lista e pagave. Andaj me qëllim të mbështetjes së pretendimit tuaj ankimor, a mund të ofroni në cilësi të provës materiale listën e pagave që ndërlidhet me periudhën kohore për marrëdhënien e punës në gazetën Bota Sot.”, ndërsa ankuesi në linjë telefonike të realizuar me datë 31.07.2025 e ka konfirmuar faktin se një provë të tillë materiale nuk e posedon.*

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, si dhe pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara në procedurë si dhe pas marrjes së veprimeve administrative në pajtueshmëri me dispozitat e LPPA-së me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike, edhe pas kërkesës ndaj ankuesit me qëllim të dhënies së mundësisë së këtij të fundit që të mbështesë pretendimin e tij ankimor, konstatoi se ankesa e ankuesit nuk është e bazuar, respektivisht ankuesi nuk ka mundur ta mbështesë me provë materiale periudhën e deklaruar të marrëdhënies së punës në gazetën Bota Sot sipas vërtetimit të datës 02.12.2020, për periudhën kohore 01.11.1999 e deri 31.12.2005, sikurse kërkohet me dispozitat e nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2023 Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, ashtu që mbështetur në konstatimin e dhënë si më lartë në atestimin e këtij vendimi Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzoi ankesën e ankuesit si në dispozitivin e këtij vendimi pasi që pretendimet e tij ankimore nuk gjetën mbështetje në kuadrin ligjor në fuqi, respektivisht pretendimet e tij ankimor nuk ka mundur t’i mbështes me prova materiale sipas kërkesave të përcaktuara me Rregulloren Nr.05/2023 Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, dhe për rrjedhojë la në fuqi aktin e kontestuar pasi që i njëjti është nxjerrë duke u bazuar në ligjin material dhe dispozitat e aplikuara nga nenin 47 dhe 48 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se nuk ia fali besimin provës së parashtruar nga ankuesi, respektivisht shkresës së Thesarit të Kosovës, ndërlidhur me konfirmimin e pagesës së pagës së muajit maj të vitit 2025, përmes të cilit pasqyrohej përvoja e punës prej 20 vitesh e 7 muaj, pasi që në kuptim të 6 paragrafi 3 të Rregullores Nr.05/2023 Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, organi kompetentë për konfirmimin apo njohjen e përvojës së punës së nëpunësit civil, është Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore në kuadër të organit të punësimit, sipas parakushteve dhe kriterëve të përcaktuara të së njëjtës rregullore, ndërlidhur me paragrafin 7 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L- për Pagat në Sektorin Publik.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1198/2025, datë 01/08/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.H;
- Komunës së Klinës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.